PUBLIC
Date original: 05/06/2025 11:06:00
Date translation: 14/01/2026 11:22:00

KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEĆA KOSOVA

Numri i lëndës:	**KSC-BC-2023-12**
	Prokurorja e Specializuar k. Hashim Thaçit, Bashkim Smakajt, Isni Kilajt, Fadil Fazliut dhe Hajredin Kuçit
Vendosi:	**Gjykatësja e Procedurës Paraprake**
	Gjykatëse Marzhori Masëlo
Administratore:	Fidelma Donlon
Data:	5 qershor 2025
Gjuha:	Anglishte
Klasifikimi:	**Publik**

Vendimi i Tretë mbi Rishikimin e Paraburgimit të Hashim Thaçit

Prokurores së Specializuar
Kimberli P. Uest

Mbrojtjes së Hashim Thaçit
Sofi Menegon
Luka Mishetiq

Mbrojtjes së Bashkim Smakaj
Xhonatan Elistan Ris
Hju Bauden

Mbrojtjes së Isni Kilaj
Ian Eduards
Xho Holms

Mbrojtjes së Fadil Fazliut
Dejvid Jang

Mbrojtjes së Hajredin Kuçit
Aleksandër Admiral

GJYKATËSJA E PROCEDURËS PARAPRAKE,[1] në bazë të nenit 41(6), (10) dhe (12) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara të Kosovës dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji") dhe rregullave 56(2) dhe 57(2) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja"), lëshon këtë vendim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 5 dhjetor 2024, Hashim Thaçit ("z. Thaçi" ose "i akuzuari"), i paraburgosur tashmë në kontekst të procesit gjyqësor *Prokurori i Specializuar k. Hashim Thaçit dhe të tjerëve* ("Çështja 06" dhe "Gjykimi *Thaçi dhe të tjerët*"), iu dorëzua fletarrestimi, i lëshuar nga Gjykatësja e Procedurës Paraprake në këtë proces gjyqësor,[2] *proprio motu* dhe pas konfirmimit të aktakuzës kundër tij, Bashkim Smakajt, Isni Kilajt, Fadil Fazliut dhe Hajredin Kuçit ("Vendimi i Konfirmimit").[3]

2. Më 8 dhjetor 2024, gjatë paraqitjes së parë të z. Thaçi, Gjykatësja e Procedurës Paraprake urdhëroi vazhdimin e paraburgimit të tij ("Vendimi mbi Paraburgimin").[4]

3. Më 7 shkurt 2025, Gjykatësja e Procedurës Paraprake urdhëroi vazhdimin e paraburgimit të z. Thaçi ("Vendimi i Parë i Rishikimit").[5]

---

[1] KSC-BC-2023-12, F00015, Kryetarja, *Decision Assigning a Pre-Trial Judge*, (Vendim për Caktimin e Gjykatëses së Procedurës Paraprake), 6 qershor 2024, publik.
[2] KSC-BC-2023-12, F00037, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën për Lëshimin e Fletarrestimeve dhe Çështje Përkatëse*, 29 nëntor 2024, konfidencial, me Shtojcat 1-8, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte; shih* Shtojcën 4, që përmban fletarrestimin kundër z. Thaçi. Versioni i redaktuar publik i parashtrimit kryesor u lëshua më 19 dhjetor 2024, F00037/RED.
[3] KSC-BC-2023-12, F00036, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Konfirmimin e Aktakuzës* 29 nëntor 2024, konfidencial. Versioni i redaktuar publik u lëshua më 12 shkurt 2025, F00036/RED.
[4] KSC-BC-2023-12, Transkripti i seancës, *Paraqitja e Parë e Hashim Thaçit*, 8 dhjetor 2024, publik, f. 18, rreshtat 10-20.
[5] KSC-BC-2023-12, F00165, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, *Decision on Review of Detention of Hashim Thaçi* (Vendim mbi Rishikimin e Paraburgimit të Hashim Thaçit), 7 shkurt 2025, publik.

4. Më 12 dhe 19 mars 2025, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, në bazë të rregullës 56(3) të Rregullores, autorizoi lirimin e përkohshëm të z. Thaçi për arsye humanitare bindëse.[6]

5. Më 7 prill 2025, Gjykatësja e Procedurës Paraprake urdhëroi vazhdimin e paraburgimit të z. Thaçi ("Vendimi i Dytë i Rishikimit").[7]

6. Më 14 prill 2025, pas vendimit të Panelit të Gjykatës së Apelit,[8] Gjykatësja e Procedurës Paraprake konfirmoi më tej për z. Thaçi formën e përgjegjësisë penale të pengimit të personave zyrtarë sipas Pikave 1, 2 dhe 3 të Aktakuzës së Konfirmuar të 2 dhjetorit 2024, në bazë të nenit 32(3) të Kodit Penal të Kosovës të vitit 2019, Ligjit nr. 06/L-074, ("Vendimi i Ndryshimit").[9]

7. Më 14 maj 2025, Zyra e Prokurores së Specializuar ("ZPS") bëri parashtrime në lidhje me rishikimin e rregullt të paraburgimit të z. Thaçi ("Parashtrimet e ZPS-së").[10]

8. Mbrojtja e z. Thaçi ("Mbrojtja e Thaçit") nuk iu përgjigj parashtrimeve të ZPS-së.

---

[6] KSC-BC-2023-12, F00213, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën Urgjente të Mbrojtjes së Thaçit për Lirim të Përkohshëm për Arsye Humanitare Bindëse,* 12 mars 2025, konfidencial dhe *ex parte*. Versioni i redaktuar publik u lëshua më 14 prill 2025, F000213/RED; KSC-BC-2023-12, F00230, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën Urgjente të Mbrojtjes së Thaçit për Lirim të Përkohshëm për Arsye Humanitare Bindëse,* 19 mars 2025, konfidencial dhe *ex parte;* F00230/COR, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, *Version i Korrigjuar i Vendimit mbi Kërkesën Urgjente të Mbrojtjes së Thaçit për Lirim të Përkohshëm për Arsye Humanitare Bindëse*, 19 mars 2025, konfidencial dhe *ex parte*, para. 22, 24-34. Versioni i redaktuar publik u lëshua më 14 prill 2025, F000230/COR/RED.

[7] KSC-BC-2023-12, F00250, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, *Second Decision on Revieë of Detention of Hashim Thaçi* (Vendimi i Dytë mbi Rishikimin e Paraburgimit të Hashim Thaçit), 7 prill 2025, publik.

[8] *Shih* KSC-BC-2023-12, IA002/F00012, Paneli i Gjykatës së Apelit, *Vendim mbi Apelin e Zyrës së Prokurorit të Specializuar kundër Vendimit mbi Konfirmimin e Aktakuzës*, 3 prill 2025, konfidencial. Versioni i redaktuar publik u lëshua më atë ditë, IA002/F00012/RED.

[9] KSC-BC-2023-12, F00260, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, *Decision Amending the "Decision on the Confirmation of the Indictment" and Setting a Date for the Submission of Preliminary Motions* (Vendim për Ndryshimin e Vendimit mbi Konfirmimin e Aktakuzës dhe Caktimin e Datës për Parashtrimet e Mocioneve Paraprake) 14 prill 2025, publik.

[10] KSC-BC-2023-12, F00300, Prokurorja e Specializuar, *Parashtrime të Prokurorisë në lidhje me Rishikimin e Paraburgimit të Hashim Thaçit*, 14 maj 2025, publike.

II. PARASHTRIMET

9. ZPS-ja kërkon që Gjykatësja e Procedurës Paraprake të vazhdojë paraburgimin e z. Thaçi, sepse nuk ka pasur ndonjë ndryshim të rëndësishëm të rrethanave që do të kërkonte nga Gjykatësja e Procedurës Paraprake të devijonte nga konstatimet e saj në Vendimin e Dytë të Rishikimit.[11]

10. Më konkretisht, ZPS-ja pretendon se paraburgimi i z. Thaçi vazhdon të jetë i domosdoshëm pasi vazhdojnë të jenë të pranishëm dhe të qartë të tri rreziqet në bazë të nenit 41(6)(b) të Ligjit[12] dhe asnjë modalitet i lirimit me kusht nuk mund të zvogëlojë mjaftueshëm këto rreziqe.[13] Sipas ZPS-së, rreziqet në fjalë mund të trajtohen në mënyrë efektive vetëm në objektin e paraburgimit të DHS-së.[14]

11. ZPS-ja shton më tej se vazhdimi i paraburgimit të z. Thaçi vazhdon të mbetet i arsyeshëm dhe proporcional sepse: (i) ndaj z. Thaçi janë ngritur (11) akuza për vepra penale sipas nenit 15(2) dhe, në qoftë se shpallet fajtor, mund të marrë një dënim të gjatë; dhe; dhe (ii) procesi po vijon me ritme të shpejta.[15] Në veçanti, ZPS-ja parashtron se, që prej Vendimit të Dytë të Rishikimit: (i) ZPS-ja ka dorëzuar njoftimin e dytë në bazë të rregullës 102(3) të Rregullores, dhe ka vazhduar të nxjerrë materiale; (ii) hapat e mbetur hetimorë po avancojnë në mënyrë efikase; dhe (iii) janë dorëzuar mocionet paraprake nga Mbrojtja.[16] Gjithashtu, ZPS-ja shton se, përmes procesit për nxjerrjen e materialit, z. Thaçi po informohet gjithnjë e më shumë lidhur me provat kundër tij.[17]

[11] Parashtrimet e ZPS-së, para. 2-4.
[12] Parashtrimet e ZPS-së, para. 5.
[13] Parashtrimet e ZPS-së, para. 5.
[14] Parashtrimet e ZPS-së, para. 5.
[15] Parashtrimet e ZPS-së, para. 6-7.
[16] Përgjigjja e ZPS-së, para. 6.
[17] Përgjigjja e ZPS-së, para. 6.

III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

12. Sipas nenit 41(6) të Ligjit, DHS-ja urdhëron arrestimin dhe paraburgimin e një personi vetëm kur (a) ekziston dyshimi i bazuar se ai e ka kryer ndonjë vepër penale që është nën juridiksionin e DHS-së; dhe (b) ekzistojnë arsye të artikulueshme të besohet se personi: (i) mund të arratiset; (ii) do të asgjësojë, fshehë, ndryshojë ose falsifikojë provat e ndonjë vepre penale, ose do të pengojë ecurinë e procesit penal duke ndikuar tek dëshmitarët, viktimat ose bashkëfajtorët, ose (iii) do ta përsërisë veprën penale, do të përfundojë ndonjë vepër penale të tentatuar, ose do të kryejë ndonjë vepër penale që ka kërcënuar se do ta kryejë.

13. Sipas nenit 41(10) të Ligjit dhe rregullës 57(2) të Rregullores, deri në kohën kur aktgjykimi të marrë formë të prerë ose deri në lirimin nga paraburgimi, me kalimin e 2 (dy) muajve nga vendimi i fundit mbi paraburgimin, Gjykatësi i Procedurës Paraprake ose paneli i ngarkuar me çështjen shqyrton nëse ekzistojnë ende arsyet për mbajtje në paraburgim dhe nxjerr vendim për vazhdimin ose ndërprerjen e paraburgimit.

14. Sipas nenit 41(12) të Ligjit, krahas masës së paraburgimit, për të siguruar praninë e të akuzuarit, përfshirë nëpërmjet videokonferencës, për të parandaluar përsëritjen e veprës penale, ose për të siguruar zhvillimin e suksesshëm të procesit penal, DHS-ja mund të urdhërojë masat në vijim: fletëthirrja, arrestimi, dorëzania, arresti shtëpiak, premtimi për të mos u larguar nga vendbanimi, ndalimi për t'iu afruar vendeve apo personave të caktuar, paraqitja në stacion të policisë apo në ndonjë vend tjetër dhe masat shmangëse.

15. Sipas rregullës 56(2) të Rregullores, Gjykatësi i Procedurës Paraprake siguron që personi të mos mbahet në paraburgim për një periudhë të paarsyeshme para hapjes së çështjes, dhe në rast të ndonjë vonese të paarsyeshme të shkaktuar nga Prokurori i Specializuar, paneli, pas dëgjimit të palëve, mund ta lirojë personin me kushte që i gjykon të përshtatshme.

IV. DISKUTIM

A. STANDARDI PËRKATËS

16. Standardi që trajton paraburgimin është trajtuar gjerësisht në vendime të mëparshme kështu që është përfshirë këtu përmes referencave.[18] Në këtë vendim Gjykatësja e Procedurës Paraprake do të zbatojë të njëjtin standard.

B. DYSHIMI I BAZUAR

17. Gjykatësja e Procedurës Paraprake rikujton se, u përcaktua në Vendimin e Konfirmuar se, në bazë të nenit 39(2) të Ligjit, ekziston dyshimi i bazuar se z. Thaçi është penalisht përgjegjës për vepra penale që përfshihen në juridiksionin e DHS-së, konkretisht për shkelje të fshehtësisë së procedurës, mosbindje ndaj gjykatës dhe pengim të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare sipas neneve 392, 393, dhe 401 të Kodit Penal të Kosovës të vitit 2019, Kodi nr. 06/L-074, në shkelje të nenit 15(2) të Ligjit.[19] Standardi mbi të cilin u bazuan këto konstatime ishte më i lartë se ai i dyshimit të bazuar që kërkohet sipas nenit 41(6)(a) të Ligjit.[20] Gjykatësja e Procedurës Paraprake vëren se në këtë çështje gjyqësore nuk ka pasur zhvillime që do t'i shfuqizonin këto konstatime.

18. Rrjedhimisht, në mungesë të ndonjë informacioni apo zhvillimi që provon të kundërtën, Gjykatësja e Procedurës Paraprake konstaton se vazhdon të ekzistojë

---

[18] *Shih* Second Review Decision (Vendimi i Dytë i Rishikimit) para. 14-15 (kritere të përgjithshme), 16 (dyshimi i bazuar), 19-22 (domosdoshmëria e paraburgimit), 36 (lirimi me kusht), 40 (proporcionaliteti), dhe referencat që gjenden në të; First Review Decision (Vendimi i Parë i Rishikimit) para. 12-13 (kritere të përgjithshme), para. 14 (dyshimi i bazuar), 17-20 (domosdoshmëria e paraburgimit), 37 (lirimi me kusht), 41 (proporcionaliteti), dhe referencat që gjenden në të.

[19] Confirmation Decision (Vendimi i Konfirmimit) para. 313(a). *Shih më lart* para. 6.

[20] *See* Confirmation Decision, (Vendimi i Konfirmimit)paras 42-43; Decision on Arrest (Vendimi për Arrestimin) para. 43. *Shih ngjashëm*, KSC-BC-2020-04, F00075/RED, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Public Redacted Version of Decision on Review of Detention of Pjetër Shala*, (Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Rishikimin e Paraburgimit të Pjetër Shalës), 10 shtator 2021, publik, para. 22; dhe F00224/RED, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Public Redacted Version of Decision on Review of Detention of Pjetër Shala* (Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Rishikimin e Paraburgimit të Pjetër Shalës), 22 qershor 2022, publik, para. 24.

dyshimi i bazuar se z. Thaçi ka kryer veprat penale të përfshira në juridiksionin lëndor të DHS-së, sipas nenit 41(6)(a) dhe (10) të Ligjit.[21]

C. DOMOSDOSHMËRIA E PARABURGIMIT

1. Rreziku i arratisjes

19. Sa i takon rrezikut të arratisjes sipas nenit 41(6)(b)(i) të Ligjit, Gjykatësja e Procedurës Paraprake konstaton se janë ende relevante të gjitha aspektet që janë përcaktuar në Vendimin e Dytë të Rishikimit, gjegjësisht: (i) pesha e veprave penale për të cilat akuzohet z. Thaçi në procesin aktual dhe mundësia e një dënimi të gjatë në rast të shpalljes fajtor;[22] (ii) synimet *mala fide* të z. Thaçi ndaj ligjeve dhe rregullave të DHS-së; dhe (iii) mjetet dhe mundësia e tij për t'u arratisur, përkundër paraburgimit të tij në procesin e Çështjes 06.[23] Krahas kësaj, Gjykatësja e Procedurës Paraprake i kushton rëndësi faktit që z. Thaçi vazhdon të njihet me provat që mbështesin akuzat kundër tij si rezultat i procesit të nxjerrjes në vijimësi të materialit.[24]

20. Rrjedhimisht, bazuar në sa më lart, dhe në mungesë të ndonjë informacioni që provon të kundërtën, Gjykatësja e Procedurës Paraprake konstaton se vazhdon të ekzistojë rreziku i arratisjes në lidhje me z. Thaçi.

2. Rreziku i pengimit të ecurisë së procesit të DHS-së

21. Sa i përket rrezikut të pengimit të procesit sipas nenit 41(6)(b)(ii) të Ligjit, Gjykatësja e Procedurës Paraprake konstaton se vazhdojnë të vlejnë aspektet e

[21] *Shih* Second Review Decision (Vendimi i Dytë i Rishikimit), para. 17-18. *Shih gjithashtu* First Review Decision (Vendimi i Parë i Rishikimit), para. 7; Vendimi mbi Paraburgimin, f. 15, rreshtat 1-7.
[22] Gjykatësja e Procedurës Paraprake shqyrtoi formën shtesë të përgjegjësisë penale, të konfirmuar rishtazi kundër z. Thaçi, që prej Vendimit të Dytë të Rishikimit, në kuadër të vlerësimit të saj aktual të rreziqeve sipas nenit 41(6)(b) (*shih më lart* para. 6).
[23] Second Review Decision (Vendimi i Dytë i Rishikimit), para. 23. *Shih gjithashtu* Vendimi mbi Paraburgimin, f. 18, rreshtat 16-24; Decision on Arrest (Vendimi për Arrestimin) para. 47-48.
[24] Gjykatësja e Procedurës Paraprake thekson se, që nga Vendimi i Dytë i Rishikimit, ZPS-ja ka nxjerrë materiale shtesë në bazë të rregullës 102(1)(b) të Rregullores. *Shih, për shembull*, Paketat nr. 24, 27-28, 30, 34, 37-38, dhe 43 të Materialeve të Nxejrra.

shqyrtuara në Vendimin e Dytë të Rishikimit, konkretisht[25]: (i) se z. Thaçi bashkërendoi me tri grupe të ndryshme, i të cilave ai ishte udhëheqës, për të ndërhyrë ndaj dëshmive të dëshmitarëve të ZPS-së në gjykimin aktual në Çështjen 06, përfshirë duke zbuluar dhe dhënë qëllimisht informacionin konfidencial në lidhje me dëshmitarë, dhe duke udhëzuar të tjerët *që të* ushtronin ndikimin të paligjshëm ndaj dëshmive të dëshmitarëve dhe *si* ta bënin këtë; (ii) se veprimet dhe sjellja e z. Thaçi janë pjesë e një praktike më të gjerë përpjekjesh për ndërhyrje në dëshmitë e dëshmitarëve të ZPS-së në Çështjen 06; (iii) se veprimet e z. Thaçi tregojnë këmbënguljen për të vijuar përpjekjet për pengim të procesit të DHS-së edhe nga brenda objektit të paraburgimit të DHS-së, përfshirë duke ushtruar ndikim mbi bashkëpunëtorë të mëhershëm të tij në UÇK që janë besnikë ndaj tij, dhe mbi njerëz nga rrethet politike të tij, si p.sh, të akuzuarit e tjerë në këtë proces; (iv) se konstatimet e mëparshme sugjerojnë se z. Thaçi tentoi të dëmtonte DHS-në, dhe, përmes rrethit të tij, u ofroi shpërblime personave të cilët u thirrën nga ZPS-ja që t'i jepnin informacion ZPS-së/DHS-së; (v) se z. Thaçi është në dijeni të akuzave dhe provave kundër tij; dhe (vi) se dijenia në rritje e tij për provat inkriminuese kundër tij shërben si motiv që të ndërhyjë ndaj dëshmitarëve ose të pengojë ecurinë e procesit aktual.[26] Gjykatësja e Procedurës Paraprake rikujton se procesi i nxjerrjes në vijimësi të materialeve rrit më tej rrezikun e pengimit të procesit, pasi i jep z. Thaçi qasje në informacion të ndjeshëm lidhur me dëshmitarët.[27]

22. Krahas sa më lart, ndonëse Gjykatësja e Procedurës Paraprake është në dijeni se ZPS-ja e ka mbyllur paraqitjen e provave të veta në çështjen gjyqësore *Thaçi dhe të tjerët*,[28] ajo vlerëson se rreziku i pengimit të drejtësisë nuk pushon së ekzistuari si

[25] Sa i përket formës së përgjegjësisë penale shtesë të konfirmuar kundër z. Thaçi, shih më lart poshtëshënimin 22.
[26] Second Review Decision (Vendimi i Dytë i Rishikimit) para. 28; First Review Decision (Vendimi i Parë i Rishikimit) para. 29-30; Vendimi mbi Paraburgimin, f. 12, rreshti 15; Decision on Arrest (Vendimi për Arrestimin), para. 50.
[27] Second Review Decision (Vendimi i Dytë i Rishikimit) para. 29 dhe referencat që gjenden në të.
[28] KSC-BC-2020-06, F03121, Prokurorja e Specializuar, *Prosecution Notice Pursuant to Rule 129* (Njoftim i Prokurorisë sipas Rregullës 129), 15 prill 2025, publik.

rezultat i kësaj, sepse: (i) procesi në çështjen 06 vazhdon ende dhe Trupi Gjykues mund të dëgjojë dëshmi të mëtejshme prej viktimave pjesëmarrëse, dëshmitarëve të Mbrojtjes dhe dëshmitarëve me kundërdëshmi, përfshirë nga dëshmitarë që tashmë mund të kenë dhënë dëshmi;[29] dhe (ii) në rrethana të jashtëzakonshme, Trupi Gjykues mund të dëgjojë dëshmi shtesë edhe pas mbylljes së paraqitjes së provave sipas rregullës 136 të Rregullores.[30] Mbi të gjitha, rreziku i pengimit të drejtësisë nuk vlerësohet vetëm në lidhje me procesin në çështjen gjyqësore 06, por edhe për këtë çështje gjyqësore. Në këtë aspekt, Gjykatësja e Procedurës Paraprake vëren se, ndonëse janë sekuestruar disa prej provave dhe janë në posedim të ZPS-së, të akuzuarit kanë njohuri të mjaftueshme për identitetin e dëshmitarëve të mundshëm, siç parashtrohet në Vendimin e Konfirmimit.[31] Çka është më e rëndësishme, Gjykatësja e Procedurës Paraprake nënvizon se rreziku i ndërhyrjes nuk lidhet vetëm me dëshmitarët që nuk kanë dhënë ende dëshmi, por ka të bëjë edhe me dëshmitarë që kanë dhënë dëshmi ndaj të cilëve mund të merret hak ose të nxiten për të tërhequr dëshmitë, çka kërcënon integritetin e gjykimit aktual në çështjen gjyqësore 06 dhe gjykimit të ardhshëm të kësaj çështje gjyqësore.

23. Së fundi, Gjykatësja e Procedurës Paraprake i vlerëson faktorët e lartpërmendur duke pasur parasysh atmosferën e përgjithshme të frikës dhe frikësimit në Kosovë kundër dëshmitarëve ose dëshmitarëve të mundshëm të DHS-

[29] *Shih, për shembull,* KSC-BC-2020-04, F00663/RED, Trupi Gjykues I, *Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Rishikimin e Trembëdhjetë të Paraburgimit të Pjetër Shalës*, 20 shtator 2023, publik, para. 18; KSC-BC-2020-05, F00355/RED, Trupi Gjykues I, *Version i Redaktuar Publik i Vendimit të Nëntë mbi Rishikimin e Paraburgimin*, 21 mars 2022, publik, para. 19.

[30] *Shih ngjashëm qasjen që është ndjekur, për shembull në*, KSC-BC-2020-04, F00838/RED, Trupi Gjykues I, *Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Rishikimin e Shtatëmbëdhjetë të Paraburgimit të Pjetër Shalës*, 17 maj 2024, publik, para. 24; F00812/RED, Trupi Gjykues I, *Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Rishikimin e Gjashtëmbëdhjetë të Paraburgimit të Pjetër Shalës*, 18 mars 2024, publik, para. 26. *Shih ngjashëm,* ICC, *The Prosecutor v. Bemba et al.*, ICC-01/05-01/13-612, Pre-Trial Chamber II, *Decision on the First Review of Jean-Jacques Mangenda Kabongo's Detention Pursuant to Article 60(3) of the Statute*, 5 August 2014, public, paras 17-18; ICC-01/05-01/13-538, Single Judge, *Decision on the First Review of Fidèle Babala Ëandu's Detention Pursuant to Article 60(3) of the Statute*, 4 July 2014, public, paras 12-13.

[31] Trupi Gjykues rikujton se vlerësimi i rreziqeve nënkupton pranimin e mundësisë, e jo të pashmangshmërisë, se ato mund të ndodhin në të ardhmen. *Shih* Second Review Decision (Vendimi i Dytë iRishikimit), para. 20 dhe referencat që gjenden në të.

së.[32] Në këtë kontekst, Gjykatësja e Procedurës Paraprake vlerëson se mbetet veçanërisht i lartë rreziku që z. Thaçi të ushtrojë trysni ndaj dëshmitarëve,[33] sidomos për shkak të lidhjeve të tij, siç përmendet më sipër.[34]

24. Rrjedhimisht, duke pasur parasysh sa më lart, dhe në mungesë të ndonjë informacioni që provon të kundërtën, Gjykatësja e Procedurës Paraprake konstaton se ekziston rreziku që z. Thaçi të pengojë ecurinë e proceseve të DHS-së.

3. Rreziku i kryerjes së krimeve të tjera

25. Sa i përket kryerjes së krimeve të tjera sipas nenit 41(6)(b)(iii) të Ligjit, Gjykatësja e Procedurës Paraprake rikujton se, edhe pse ekzistenca e rrezikut të pengimit të procesit nuk nënkupton automatikisht rrezikun e kryerjes së krimeve të tjera, në rrethanat e çështjes aktuale, faktorët mbi të cilët mbështetet rreziku i parë janë relevante edhe për vlerësimin e këtij të fundit.[35] Në lidhje me këtë, Gjykatësja e Procedurës Paraprake thekson se faktorët relevantë që duhet të merren parasysh janë të njëjtët faktorë të paraqitur në paragrafët 21-22 më lart në lidhje me pengimin e procesit. Për këto arsye, Gjykatësja e Procedurës Paraprake konstaton se ekziston rreziku që z. Thaçi do të përsërisë veprat penale të cilat pretendohet se i ka kryer, përfshirë në lidhje me dëshmitarët që kanë dhënë ose do të japin dëshmi në çështjen 06 dhe/ose në këtë çështje.[36]

26. Rrjedhimisht, bazuar në sa më lart dhe në mungesë të ndonjë informacioni që provon të kundërtën, Gjykatësja e Procedurës Paraprake arrin në përfundimin se vazhdon të ekzistojë rreziku që z. Thaçi të kryejë krime të tjera.

---

[32] Second Review Decision (Vendimi i Dytë i Rishikimit), para. 30; First Review Decision (Vendimi i Parë i Rishikimit), para. 31; Vendimi mbi Paraburgimin, f. 18, rreshtat 16-20; Decision on Arrest (Vendimi për Arrestimin), para. 51.
[33] *Shih* Vendimin e Dytë të Rishikimit, para. 30 dhe referencat që gjenden në të; First Review Decision (Vendimi i Parë i Rishikimit), para. 31.
[34] *Shih më laet,* para. 21.
[35] First Review Decision (Vendimi i Parë i Rishikimit), para. 33; Vendimi mbi Paraburgimin, f. 15, rreshtat 3-7; Decision on Arrest (Vendimi për Arrestimin), para. 53.
[36] *Shih gjithashtu* First Review Decision (Vendimi i Parë i Rishikimit), para. 34; Vendimi mbi Paraburgimin, p. 18, lines 16-20; Decision on Arrest (Vendimi për Arrestimin), para. 54.

4. Përfundim

27. Duke pasur parasysh sa më lart, Gjykatësja e Procedurës Paraprake konstaton se ka arsye të artikulueshme për të besuar se z. Thaçi mund të arratiset, të pengojë ecurinë e procesit të DHS-së, ose të kryejë vepra penale të tjera, çka bën të domosdoshëm vazhdimin e paraburgimit të tij në përputhje me nenin 41(6)(b) të Ligjit. Gjykatësja e Procedurës Paraprake më poshtë do të vlerësojë nëse këto rreziqe mund të zvogëlohen në masë të mjaftueshme me kushtet për lirimin e z. Thaçi.

D. LIRIMI ME KUSHT

28. Gjykatësja e Procedurës Paraprake mbetet e mendimit se asnjë kusht nuk do të mund të ulë rreziqet në këtë fazë, veçanërisht rrezikun që i akuzuari të pengojë ecurinë e procesit të DHS-së ose të kryejë vepra penale të tjera.[37] Konkretisht, Gjykatësja e Procedurës Paraprake është e mendimit se asnjë kusht i mundshëm i përcaktuar: (i) nuk trajton, për shembull, mundësinë që z. Thaçi të shfrytëzojë të tjerë ose të përdorë pajisje për komunikim të personave të tjerë ose t'u kërkojë personave të tjerëve të përdorin pajisjet e tyre për të ndërhyrë paligjshëm ndaj dëshmitarëve; dhe (ii) nuk mund të sigurojë monitorim efektiv të komunikimeve të z. Thaçi. Gjykatësja e Procedurës Paraprake mban parasysh gjithashtu se, përkundër kushteve (në qoftë se lirohet), i akuzuari do të jetë në gjendje, do të ketë motiv dhe do të ketë mundësi të këmbëngulë në vazhdimin e përpjekjeve për pengim të procesit të DHS-së.[38]

29. Gjithashtu, sipas mendimit të Gjykatëses së Procedurës Paraprake, megjithëse rreziku i mesazheve dhe udhëzimeve të paligjshme nuk mund të eliminohet plotësisht, masat në fuqi në objektin e paraburgimit të DHS-së, të marra në tërësi,

[37] Second Review Decision (Vendimi i Dytë i Rishikimit), para. 37; First Review Decision (Vendimi i Parë i Rishikimit), para. 38; *shih* KSC-BC-2020-06, IA017/F00011/RED, Paneli i Gjykatës së Apelit, *Public Redacted Version of Decision on Hashim Thaçi's Appeal Against Decision on Review of Detention* (Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Apelin e Hashim Thaçit kundër Vendimit për Rishikimin e Paraburgimit), 5 prill 2022, publik, para. 51.
[38] Second Review Decision (Vendimi i Dytë i Rishikimit), para. 37; First Review Decision (Vendimi i Parë i Rishikimit), para. 38.

ofrojnë garanci të forta kundër vizitave dhe komunikimeve të pamonitoruara me anëtarë të familjes dhe vizitorë të miratuar paraprakisht, me synimin për të zvogëluar sa më shumë rrezikun e pengimit të procesit dhe të kryerjes së veprave penale të tjera.[39] Në lidhje me këtë, Gjykatësja e Procedurës Paraprake rikujton se Administratorja dhe trupi gjykues, që kanë qasje të pakufizuar në informacion konfidencial në lidhje me dëshmitarët dhe viktimat, mund të ndërmarrin veprime më shpejt se autoritetet e tjera që veprojnë sipas një kornizë të ndryshme.[40]

30. Rrjedhimisht, bazuar në sa më lart, Gjykatësja e Procedurës Paraprake arrin në përfundimin se çfarëdo kushti i arsyeshëm i caktuar nga Gjykatësja e Procedurës Paraprake është i pamjaftueshëm për të ulur rreziqet sipas nenit 41(6)(b)(i)-(iii) të Ligjit.

E. PROPORCIONALITETI I PARABURGIMIT

31. Fillimisht, Gjykatësja e Procedurës Paraprake rikujton se: (i) z. Thaçi gjendet në paraburgim që nga 5 dhjetori 2024 në kontekst të këtij procesi;[41] (ii) kundër tij janë ngritur tri (3) akuza për pengim të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare, katër (4) akuza për shkelje të fshehtësisë së procesit dhe katër (4) akuza për mosbindje ndaj gjykatës, për të cilat ai mund të dënohet, përkatësisht, deri në pesë (5) vjet, tre (3) vjet dhe gjashtë (6) muaj burgim;[42] dhe (iii) rreziqet e parapara

[39] Second Review Decision (Vendimi i Dytë i Rishikimit), para. 38; First Review Decision (Vendimi i Parë i Rishikimit), para. 39. *Ngjashëm,* KSC-BC-2020-06, IA010/F00008/RED, Paneli i Gjykatës së Apelit, *Public Redacted Version of Decision on Hashim Thaçi's Appeal Against Decision on Review of Detention* (Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Apelin e Hashim Thaçit kundër Vendimit për Rishikimin e Paraburgimit), 27 tetor 2021, publik, para. 68.

[40] Second Review Decision (Vendimi i Dytë i Rishikimit), para. 38; First Review Decision (Vendimi i Parë i Rishikimit), para. 39. *Shih ngjashëm* KSC-BC-2023-10, F00165, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Public Redacted Version of Decision on Review of Detention of Haxhi Shala* (Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Rishikimin e Paraburgimit të Haxhi Shalës), 9 shkurt 2024, publik, para. 54.

[41] *Shih më lart* para. 1.

[42] KSC-BC-2023-12, F00264/A02, Prokurorja e Specializuar, *Public Redacted Amended Confirmed Indictment* (Version i Redaktuar Publik i Aktakuzës të Konfirmuar të Ndryshuar), ("Aktakuza e Konfirmuar e Ndryshuar"), 16 prill 2025, publik, para. 45.

në nenin 41(6)(b)(ii) dhe (iii) të Ligjit nuk mund të zvogëlohen me asnjë prej kushteve të propozuara për lirim.[43]

32. Gjykatësja e Procedurës Paraprake merr parasysh gjithashtu faktin se, që nga Vendimi i Dytë i Rishikimit: (i) ZPS-ja ka përfunduar (në pjesë të madhe) nxjerrjen e provave që ka në zotërim, sipas rregullës 102(1)(b) të Rregullores,[44] dhe ka nxjerrë materiale të tjera sipas rregullës 103 të Rregullores;[45] (ii) ZPS-ja ka dorëzuar njoftimin e dytë sipas rregullës 102(3) të Rregullores[46] dhe ka nxjerrë një numër të materialeve sipas kërkesës së Mbrojtjes;[47] (iii) kryerja e hapave hetimorë të mbetur vijon në mënyrë të rregullt;[48] (iv) ZPS-ja ka dorëzuar dhe ka ndryshuar Aktakuzën e Konfirmuar të ndryshuar[49] pas konfirmimit të akuzave të ndryshuara kundër z. Thaçi;[50] dhe (v) ekipet e Mbrojtjes kanë dorëzuar mocionet paraprake.[51]

---

[43] *Shih më lart* para. 30.

[44] *Shih* Paketat nr. 24, 27-28, 30, 34, 37-38 dhe 43 të materialit të nxjerrë. *Shih gjithashtu* KSC-BC-2023-12, F00100, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, *Framework Decision on Disclosure of Evidence and Related Matters* (Vendim Kornizë mbi Nxjerrjen e Provave dhe Çështje lidhur me To), 20 dhjetor 2024, publik, para. 45, 104(c), (e) (që cakton afatin për nxjerrjen e këtij materiali deri më 17 mars 2025); F00256, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, *Vendim për Autorizimin e Nxjerrjes së Materialit Shtesë sipas Rregullës 102(1)(b) të Rregullores*, 11 prill 2025, publik.

[45] *Shih* Paketat nr. 26, 29, 33, 41 dhe 45 të Materialit të Nxjerrë.

[46] *Shih* KSC-BC-2023-12, F00265, Prokurorja e Specializuar, *Njoftimi i Dytë i Prokurorisë sipas Rregullës 102(3)*, 17 prill 2025, publik, me Shtojcën 1, konfidenciale.

[47] *Shih* Paketat nr. 25, 31-32, 35-36, 39, 40, 44

[48] *Shih* KSC-BC-2023-12, F00254, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën e Prokurorisë për Dorëzim Materiali*, 10 prill 2025, konfidencial; F00266, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën e Prokurorisë për Dorëzim të të Dhënave dhe Kërkesën lidhur me To*, 22 prill 2025, konfidenciale, me Shtojcën 1, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*; F00284, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Emërimin e Mbrojtësit të Pavarur*, 7 maj 2025, konfidencial; F00291, Administratorja, *Parashtrimet e Pesta të Zyrës Administrative në lidhje me Zbatimin e Kërkesës për Ndihmë F00039*, 8 maj 2025, konfidencial; F00296, Administratorja, *Parashtrimet e Gjashta të Zyrës Administrative në lidhje me Zbatimin e Kërkesës për Ndihmë nr. F00039*, konfidenciale, me Shtojcën 1, konfidenciale; F00299, Administratorja, *Njoftim lidhur me Emërimin e Mbrojtësit të Pavarur*, 13 maj 2025, konfidencial, me Shtojcën 1, konfidenciale; F00304, Administratorja, *Njoftim i Zyrës Administrative për Fillimin e Fazës 1 të Zbatimit në bazë të Urdhrit F00221*, 14 maj 2025, konfidencial.

[49] *Shih* Amended Confirmed Indictment (Aktakuza e Konfirmuar e Ndryshuar)

[50] *Shih* KSC-BC-2023-12, F00260, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, *Decision Amending the "Decision on the Confirmation of the Indictment" and Setting a Date for the Submission of Preliminary Motions* (Vendim për Ndryshimin e Vendimit mbi Konfirmimin e Aktakuzës dhe Caktimin e Datës për Parashtrimet e Mocioneve Paraprake), 14 prill 2025, public.

[51] *Shih* KSC-BC-2023-12, F00285, Mbrojtja e Thaçit, *Mocion Paraprak i Mbrojtjes së Thaçit që Kërkon Veçim të Aktakuzës dhe Shtyrje të Procesit lidhur me z. Tha*çi, 7 maj 2025, publik, me Shtojcën 1, publike; F00286, Mbrojtja e Bashkim Smakajt, Isni Kilajt, Fadil Fazliut ("Mbrojtja e Fazliut") dhe Hajredin

Rrjedhimisht, procesi po avancon me shpejtësi, duke e sjellë çështjen edhe më afër kalimit te trupi gjykues.

33. Gjykatësja e Procedurës Paraprake ka shqyrtuar me kujdes kohën shtesë që ka kaluar z. Thaçi në paraburgim që prej Vendimit të Dytë të Rishikimit, por konstaton se – në raport me faktorët e mbetur, të përcaktuar në paragrafët 31-32 më lart – paraburgimi i tij mbetet proporcional.

34. Gjithashtu, në bazë të nenit 41(10) të Ligjit dhe rregullës 57(2) të Rregullores, paraburgimi i z. Thaçi do të rishikohet rregullisht pas kalimit të dy (2) muajve nga vendimi i fundit për paraburgimin, ose në çdo kohë me kërkesë të të akuzuarit ose të ZPS-së, ose *proprio motu*, nëse që nga vlerësimi i fundit ka ndryshim të rrethanave.

35. Bazuar në sa më sipër, Gjykatësja e Procedurës Paraprake konstaton se z. Thaçi nuk është mbajtur në paraburgim për një periudhë të paarsyeshme brenda kuptimit të rregullës 56(2) të Rregullores.

V. VENDIM

36. Për arsyet e lartpërmendura, Gjykatësja e Procedurës Paraprake:

a. **URDHËRON** vazhdimin e paraburgimit të z. Thaçi;

b. **URDHËRON** z. Thaçi, që, nëse dëshiron, të paraqesë parashtrime në lidhje me rishikimin e ardhshëm të paraburgimit deri **të**

Kuçit, *Mocion Paraprak i Përbashkët i Mbrojtjes në bazë të Rregullës 97 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës*, 7 maj 2025, publik F00288, Mbrojtja e Thaçit, *Mocion i Mbrojtjes së Thaçit për Mangësi në Aktakuzë*, 8 maj 2025, publik; F00289, Mbrojtja e Fazliut, *Kundërshtim i Mbrojtjes së Fazliut ndaj Mangësive në Formën e Aktakuzës*, 8 maj 2025, publik; F00290, Mbrojtja e Thaçit, *Mocion Paraprak i Mbrojtjes së Thaçit mbi Juridiksionin*, konfidencial dhe *ex parte*, me Shtojcën 1, konfidenciale dhe *ex parte* (versioni i redaktuar publik i parashtrimit kryesor dhe Shtojcës u dorëzuan më 12 maj 2025, përkatësisht F00290/RED dhe F00290/A01/RED). *Shih gjithashtu* KSC-BC-2023-12, F00306, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën e Prokurorisë për Zgjatje të Afatit për Përgjigjet lidhur me Mocionin Paraprak*, 15 maj 2025, publik.

premten, 27 qershor 2025, me përgjigjet dhe kundërpërgjigjet sipas afateve të përcaktuara në rregullën 76 të Rregullores; dhe

c. **URDHËRON** ZPS-në që, nëse z. Thaçi vendos të mos paraqesë parashtrime deri në afatin e lartpërmendur, të paraqesë parashtrime në lidhje me rishikimin e ardhshëm të paraburgimit të z. Thaçi deri **të hënën, 7 korrik 2025**, dhe z. Thaçi, që, nëse dëshiron, të paraqesë përgjigjen e tij deri **të hënën, 14 korrik 2025**.

/nënshkrimi/

Gjykatëse Marzhori Masëlo

Gjykatëse e Procedurës Paraprake

E enjte, 5 qershor 2025

Në Hagë, Holandë